

Procesverbal

Nga takimi i tretë (i tretë) i rregullt i Komitetit për Komunitete, i mbajtur më: 07.03.2025.

Rendi i ditës

- 1) Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,*
- 2) Shqyrtimi i materialit kuvendor për seancën e tretë (të tretë),*
- 3) Eventuale.*

Miralem Rahte: Të nderuar anëtarë të Komisionit për Komunitete, përfaqësues të OSBE-së, të gjithë mysafirë të pranishëm, po hap mbledhje e 3 të Komitetit për Komunitete për këtë vit, para fillimit të këtij takimi dua të konstatoj nëse kemi kuorum. Meqenëse kemi, Më lejoni të bëj një pyetje, a e morën të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete materialin në kohën e përcaktuar ligjërisht, të përkthyer në gjuhët tuaja amtare? A ka dikush ndonjë fjalë për rendin e ditës? Po hedh në votim miratimin e axhendës së sotme të propozuar. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Meqenëse rendi i ditës është miratuar, kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

Suada Bajrami – Përshendetje për të gjithë, para se të hidhët në votim rendi i ditës, ne në fshatin Shajne kemi pas një tubim, të thirur nga fshati Shajne rreth pikës së shtatë të rendit të ditës për të cilën banor të fshatit janë për mos të futët si pikë e rendit të ditës fare në votim. Dmth.me e hek prej rendit të ditës. Pas takimit rrjedhi një takim me Kryetarin e komunës bashkë me Kryesuesen e Kuvendit. Kryetari pasi e degjojë të gjitha shqetësime dhe arsyet, se bashku me Kryesuesën morri vendim që kjo pikë të mos futet fare në votim. Edhe unë gjithashtu këtkoj që mos të futet në rendin e ditës.

Nedžmidin Sejdilar – Më vjen mirë që dolët në foltore dhe që na informuat për atë që ndodhi në atë mbledhje, do të doja që dikush nga ekzekutivi që ishte aty të na sqaronte. Duke pasur parasysh se kryetari i komunës po e bojkoton këtë komitet, kërkuj që nënkryetari të na informojë. Unë nuk jam kundër, edhe unë jamë për heqjes së asaj pike nga rendi i ditës.

Resul Fetahu – Siq e dini Kryetari bashkë me Kryesuesen ka marrt pjes në takim me banor të fshatit Shajne, ku kanë diskutue lidhur me qitjen dhe mos qitjen e pikës në rend të ditës. Kanë vendosur që nesër mos të diskutohet kjo pikë dhe të hiqt nga rendi i ditës.

Miralem Rahte – Kush është pro pa pikën 7 të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se propozimi është miratuar.

Pika I - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mëparshme

Z. Miralem Rahte - A ka dikush fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës dhe procesverbalit. Meqenëse nuk ka, e vura në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

Pika II - Shqyrtimi i materialeve të Kuvendit për seancën e tretë,

A dëshiron dikush të marrë fjalën në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës?

- A ka dikush fjalë për këtë pikë, Propozimin për vendim për kalimin e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 në 2025. Kush është pro, kundër, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- A ka dikush fjalë në lidhje me këtë pikë, Propozim për vendim për deklarin e interesit të përgjithshëm publik P-70604014-00807-0 KZ Dragash, Meqë nuk ka, këtë pikë të rendit të ditës e hodha në votim. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- A ka dikush fjalën në lidhje me këtë pikë, Propozim vendim për rishpërndarjen e mjeteve buxhetore për vitin 2025. Meqenëse nuk ka, po e hedh në votim miratimin e kësaj pike në rend dite. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- A ka dikush fjalën në lidhje me këtë pikë, Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për publikimin e listës së përgjithshme dhe të posaçme të pronave të paluajtshme të Komunës për vitin 2025. Meqë nuk ka, e hodha në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- A ka dikush fjalë për këtë pikë, Propozimin për Vendim për emërimin e Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve në institucionet arsimore në komunën e Dragashit. Meqenëse nuk ka, e vura në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- A ka dikush për të thënë për këtë pikë. Propozim vendim për anulimin e vendimit për deklarin e interesit publik 01Nr.060/01-3240-1/25 dhe dt. 28.02.2025, 01Nr.060/01-3240-2/25 dhe dt. 28.02.2025, 01Nr.060/01-3240-3/25 dhe dt. 28.02.2025, 01Nr.060/01-3240-4/25 dhe dt. 28.02.2025 dhe 01Nr.060/01-3240-5/25 dhe dt. 28.02.2025. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

- A ka dikush për të thënë për këtë pikë. Përgjigjet e pushtetit ekzekutiv për pyetjet e deputetëve nga seanca e dytë e Kuvendit. Meqenëse nuk ka, e vura në votim miratimin e kësaj pike të rendit të ditës. Kush është pro-, kundër-, abstenime-. Konkludoj se kjo pikë e rendit të ditës është miratuar.

Pika e tretë e rendit të ditës

Miralem Rahte: A ka diskutues lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. A kemi ndonjë kërkesë drejtuar Komisionit? A dëshiron dikush i pranishëm të marrë fjalën dhe të hapë një diskutim? Meqë nuk ka, me këtë mbyll seancën e sotme të Komitetit për Komunitete.

Kryesuesi i K.Komuniteteve

Miralem Rahte